



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. ____ . Prot
____ / ____ /2018

Datë

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për Shoqërinë: JUNIK sh.p.k me NIPT J68007522L me adrese ne: Lezhe Lagjia SMT, Ndertese 2- Kateshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë.

Procedura e Prokurimit: “ Proçedure e Hapur” punë.

Numri i Referencës se proçedurës/lotit: REF-80817-07-26-2018

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: “Rikonstruksion+ Shtese e shkolles së Bashkuar, Hajmel-Vau Dejes” **me fond limit:** 74.996.610,00(shtatëdhjetë e kater milion e nëntëqinde nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa T.V.SH, **me afat kohor për ekzekutimin:** 140 ditë kalendarike.

Burimi i Financimit: “ Buxheti i Shtetit”

Data e zhvillimit të proçedurës së prokurimit: 03.09.2018 ora 10:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 30 me datë 30.07.2018

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë proçedurë 3 operatore ekonomike me vlerën përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik:** JUNIK sh.p.k me NIPT J68007522L me adrese ne: Lezhe Lagjia SMT, Ndertese 2- Kateshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë ka paraqitur oferten me vlerë: **70.204.792,00** (shtatëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy lekë) pa tvsh ose **84.245.750,00** (tetëdhjetë e katër milion e dyqind e dyzet e pese mije e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë me tvsh.
- 2. Operatori ekonomik:**JV “AGRI KONSTRUKSION” sh.p.k me NIPT K01725001F dhe “KACDEDJA” sh.p.k, me NIPT K51712017A, kanë paraqitur oferten me vlerë: **49.779.964,00** (dyzet e nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjete e katër) lekë pa tvsh ose **59.735.956,00** (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh.
- 3. Operatori ekonomik:** “ELDA-VL” shpk me numer NIPTI K67106202W, me

adresë në Vlore L.H.CAKERRI 88. **Nuk ka ka paraqitë ofertë.**

❖ **Eshte Skualifikuar operatori ekonomik :**

1. **“ELDA-VL” sh.p.k Arsyet e skualifikimit:**

Nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e mëposhtme të kërkuara sipas Dokumenteve Standarte të Tenderit:

. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- c. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- ç. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- d. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin sipas shtojces 12

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- Kopje të deklarimit të xhiros mesatare vjetore të viteve të fundit (2015, 2016, 2017) duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se 50 % të fondit limit të objektit që prokurohet.
- Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve të fundit (2015, 2016, 2017) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë , të shoqëruar me Raport të Ekspertit Kontabël për sejeilin vit.
- Vërtetim i lëshuar nga Njesite e Qeverisjes Vendore për shlyerjen e taksave Vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet, 2016, 2017, 2018 prane të gjitha njesive vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKR.(Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë vërtetim).
- Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.
- Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit²⁸.

2.3 Per Kapacitetin teknik:

- Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:
 - a) punë të ngjashme, për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
OSE
 - b) punë të ngjashme, ku vlera totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.a) plotësohet nga anëtari, i cili ka % më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.

Ndërsa pika 2.3.b) duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparëshme kërkohën:

a) për punë publike:

- Kontratë sipërmarrje
- Situacion përfundimtar
- Akt Kolaudimi
- Formular vlerësimi

b) për punë më investime private:

- Kontratë sipërmarrje
- Situacion përfundimtar
- Faturë Tatimor


- Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

| | |
|----------------------|---|
| N.P- 1, Klasifikimi | A |
| N.P-2, Klasifikimi | C |
| N.P- 3 , Klasifikimi | C |
| N.P-11 , Klasifikimi | A |
| N.P -12, Klasifikimi | B |
| N.S-1 , Klasifikimi | A |
| N.S -2, Klasifikimi | A |
| N.S-4, Klasifikimi | C |
| N.S-8, Klasifikimi | A |
| N.S-9, Klasifikimi | A |
| N.S-12, Klasifikimi | B |
| N.S-13, Klasifikimi | A |
| N.S-14, Klasifikimi | A |
| N.S-18, Klasifikimi | A |

- Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore Tipi C, Kodi III.a.A lëshuar nga QKL.
- Numri mesatar i punonjesve të operatorit ekonomik ofertues të siguruar për periudhën **Janar 2018- Korrik 2018**, të jetë jo më i vogël se 140 punonjës, i vertetuar nga organet tatimore. Të shoqërohen me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve.
- Operatori ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në Liçensën e shoqërisë:
 - Inxhinier Ndërtimi
 - Inxhinier Mekanik
 - Inxhinier Elektrik
 - Inxhinier Mjedisori
 - Inxhinier Hidroteknik
 - Inxhinier Gjeodet(Topograf)

Për secilin të paraqitet kontrata Noteriale dhe diplomë

- Operatori ekonomik duhet të provojë se ka në stafin e tij të paktën për periudhën Janar-Korrik 2018:
 - Të paktën 1(një) Inxhinier Ndërtimi



- Të pakten 1(një) Inxhinier Elektrik
- Të pakten 1(një) Inxhinier Mjedisi
- Të pakten 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- Të pakten 1(një) Arkitekt

Për secilin të paraqitet kontrata Pune dhe diplomë

- Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin: *Kontratë pune dhe Diplomë*.
- Kandidati ofertues duhet të ketë minimumi 55(pesëdhjetë e pesë) punonjës të certifikuar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik, ose nga organe kompetente për certifikim nga të cilët të ketë këto profesione:
 - Specialist Ndërtimi
 - Karpentier
 - Hekurkthyes
 - Murator
 - Hidraulik
 - Elektriçist
 - Punues mermeri ose guri
 - Bojaxhi
 - Montator
 - Punëtor izolimi
 - Shtrues Pllakash

Punonjësit e certifikuar duhet të figurojnë në Listpagesat e shoqërisë të pakten për 6-mujorin e fundit.

- Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar nje Mjek, per te cilin duhet te paraqesë kontrate pune, cv, diploma dhe Libreze pune, urdher mjeku.(në rast bashkimi operatorësh, secili duhet të ketë 1 Mjek të punësuar).
- Operatori Ekonomik duhet të disponoj mjetet e meposhtme pronesi/qera:

| | |
|--|--------------------|
| - Kamion mbi 15 Ton | 2 copë |
| - Kamionçin me aftësi mbajtëse të pakten 1 Ton | 3 copë |
| - Minieskavator | 2 copë |
| - Minifadromë | 1 copë |
| - Depozitë uji 5000 Litra | 2 copë |
| - Gjenerator mbi 200 KË | 2 copë |
| - Kontenier Kantjeri | 2 copë |
| - Tranxhe hekuri | 1 cope |
| - Çekiç elektrik | 1 copë |
| - Makineri ngjitje tubash me elektrofuzion | 1 copë |
| - Makineri për kthim hekuri | 1 copë |
| - Makineri për nivelim shtresash | 1 copë |
| - Matrapik | 3 copë |
| - Saldatriçe | 2 copë |
| - Kompresor | 2 copë |
| - Betoniere | 2 copë |
| - Rrul ngjeshës | 1 copë |
| - Skela ndërtimi + rrjete | 2000m ² |

- Betoforma

1500 m²

Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimi në fjalet si dhe afati i saj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje qarkullimi, çertifikatë kontrolli teknik, vërtetim i pagesës për taksat vendore, çertifikatë pronësie, çertifikatë transport mallrash brenda vendit dhe foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese), si dhe deklarate nga administratori i shoqërisë që mjete e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.

- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me çrtifikatat e mëposhtme:

Çertifikatë ISO 9001- 2015 (e vlefshme)

Çertifikatë ISO 50001- 2011 (e vlefshme)

Çertifikatë ISO 3834-2- 2006 (e vlefshme)

Çertifikatë ISO 14001- 2015 (e vlefshme)

Çertifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme)

Çertifikatë PASS 99:2012 (e vlefshme)

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mësipërme.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Per sa me siper ju skualifikoheni nga kjo procedure prokurimi!

2.Është skualifikuar bashkimi i operatoreve ekonomike “AGRI KONSTRUKSION” sh.p.k dhe “KACDEDJA” shpk:

Arsyet e skualifikimit:

*Tërhequr nga oferta e paraqitur, për të cilën ka dhënë informacion: **Me shkresën nr. 188 prot me datë 18.09.2018** drejtuar Bashkisë Vau Dejes nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “AGRI KONSTRUKSION” sh.p.k dhe “KACDEDJA” sh.p.k me **Lënde: “Njoftim për tërheqje nga procedura e tenderit, me objekt:”Rikonstruksion +Shtesë e Shkollës së Bashkuar, Hajmel –Vau –Dejes”.***

*Ju keni njoftuar si perfaqesues i bashkimit të operatoreve ekonomike “AGRI KONSTRUKSION” sh.p.k dhe “KACDEDJA” sh.p.k, bazuar në prokurën nr. 7293 rep., nr. 5325 kol., datë 31.08.2018, si pjesëmarrës në procedurën :”Rikonstruksion +Shtesë e Shkollës së Bashkuar, Hajmel –Vau –Dejes”, me AK Bashkia Vau Dejes, të zhvilluar me datë 03.09.2018, duke qenë se gjatë kësaj periudhe jeni të angazhuar në kontrata të tjera, **Terhiqeni nga kjo procedure prokurimi.***

Per sa me siper ju skualifikoheni nga kjo procedure prokurimi!

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik: **JUNIK sh.p.k** me NIPT J68007522L me adrese në: Lezhe Lagjia SMT, Ndertese 2- Kateshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Lezhë ka paraqitur oferten me vlerë: **70.204.792,00** (shtatëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy lekë) pa tvsh ose **84.245.750,00** (tetëdhjetë e katër milion e dyqind e dyzet e pese mije e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë me tvsh, **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejes, qyteti Vau Dejes sigurimin e Kontrates, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 diteve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me këto kërkesë, ose terhiqeni nga nënshkrimi i kontrates, tenderi do të anulohet si pasoje e mospasjes së një subjekti tjetër të suksesshem, në baze të ligjit nr 9643, datë 20.11.2007 ” Per Prokurimin Publik, i ndryshuar”, neni 24, pika ç.

Njoftimi i klasifikimit është bërë me datë **19/09/2018**

Ankesa: Nuk ka.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

ZEF HILA